# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457306**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Jep dorëheqjen kreu i Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, pas kritikave për manekinin e Çerçiz Topullit në muze - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/jep-doreheqejen-kreu-i-trashegimise-kulturore-gjirokaster-pas-kritikave-per-mankininin-e-cerciz-topullit-ne-muze/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 10:06:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 10:03:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c731041ebe7ec2e1ab96a1fdcec5818cb8a92101e8ee5d396a83d7cabbc23e0c` |
| TEKSTI | `0472508657d13332ae40dca6a0a3fb9d7707843d528b9a90417007d820e66103` |
| PAMJA | `fc53b29e649aee31e2157ff7f70a9a4c637617374d95168e1f993d40df939082` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c3067daae24c281e7e5e1304d4b7b14a1bcd98772869c083f509d228e6b19de1` |
| E MËPARSHMJA | `e51055c66e0981a8c515797c047201e35b4bd1995166953041a53b0c53463706` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c3067daae24c281e7e5e1304d4b7b14a1bcd98772869c083f509d228e6b19de1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | VENDI

# Jep dorëheqjen kreu i Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, pas kritikave për manekinin e Çerçiz Topullit në muze

19 Shtator 2026 | 12:03

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Florian Hysi nuk do të jetë më në krye të Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastër. Ai ka vendosur të largohet nga detyra, pas reagimit të krijuar rreth mënyrës së prezantimit të veshjeve të heroit kombëtar Çerçiz Topulli në Muzeun e Kalasë.

Hysi ia ka dorëzuar dorëheqjen kryebashkiakut Flamur Golemi, duke marrë përsipër përgjegjësinë për mënyrën se si ishte realizuar ekspozimi.

Shkak për reagimet u bë manekini i përdorur për të paraqitur veshjet e Çerçiz Topullit, veçanërisht portreti i vendosur në të, i cili u konsiderua i papërshtatshëm për një figurë të rëndësishme të historisë shqiptare.

Pas reagimeve, portreti është hequr dhe veshjet e heroit janë vendosur në një manekin pa fytyrë.

Në deklaratën për largimin nga detyra, Hysi thotë se vendimi është marrë për shkak të përgjegjësisë që, sipas tij, duhet të mbajë çdo drejtues për vendimet dhe gabimet e mundshme gjatë ushtrimit të funksionit.

"Ajo që u konsiderua gabim u korrigjua dhe marr të gjithë përgjegjësinë përsipër", shprehet Hysi.

Ai falënderon Bashkinë e Gjirokastrës, kolegët dhe punonjësit e Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore, ndërsa thekson se gjatë periudhës në detyrë janë realizuar një sërë punësh në fushën e muzeve dhe trashëgimisë.

"Dorëheqja ime nuk është dorëzim nga ajo që besoj. Është një akt përgjegjësie dhe respekti për institucionin", shkruan ai.

Në fund të deklaratës, Hysi shprehet se do të vijojë të mbështesë Gjirokastrën dhe trashëgiminë e saj kulturore, ndërsa e mbyll me mesazhin:

"Ne u përpoqëm, atë që u konsiderua gabim e korrigjuam dhe punën do ta lëmë të flasë vetë".

Florian Hysi e ka firmosur deklaratën e dorëheqjes më 19 gusht 2026.

LAJMI I FUNDIT

13:55 **Dy dronë të paidentifikuar shkelin hapësirën ajrore të Moldavisë, alarm në Kishinau**

13:43 **I akuzuar për spiunazh në favor të Izraelit, Irani ekzekuton një tjetër të dënuar**

13:30 **Sulmet ruse vrasin 11 persona dhe plagosin dhjetëra të tjerë gjatë 24 orëve të fundit në Ukrainë**

13:18 **U kap duke transportuar 7 emigrantë të paligjshëm, arrestohet 32-vjeçari, në kërkim bashkëpunëtori**

13:08 **Kryeministri Rama vizitë në SHBA, merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së**

13:04 **Trump nënshkruan ligjin për sanksione gjithëpërfshirëse ndaj Rusisë, synohet goditja e ekonomisë dhe "flota në hije"**

TESTIM

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

### U kap duke transportuar 7 emigrantë të paligjshëm, arrestohet 32-vjeçari, në kërkim bashkëpunëtori

Një 32-vjeçar është vënë në pranga këtë të shtunën nga policia e Korçës, pasi u kap në flagrancë duke u dhënë ndihmë disa emigrantëve për...

13:19 | 19/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

### Kryeministri Rama vizitë në SHBA, merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së

Kryeministri Edi Rama do të zhvillojë një vizitë disaditore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të pjesëmarrjes në punimet e Asamblesë së Përgjithshme...

13:08 | 19/09/2026

AKTUALITET | EURONEWS ALBANIA | VENDI

### Vrau gruan me thikë në sy të nipit, autori arratiset nga ngjarja! Dalin emrat

Dalojnë detaje të reja nga ngjarja e rëndë e raportuar në Tiranë, ku gruaja Lumturie Patushi dyshohet se është vrarë me thikë nga bashkëshorti i...

12:24 | 19/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.